

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****AC-I-22-0584*****Në ankesën e******Paditësja***

N K, në emër të bashkëshortit të ndjerë **A K** nga, Prizreni, e përfaqësuar nga Avokatja **N M** dhe Avokati **D Sh** nga Prizreni.

kundër***E paditura/Ankuesja***

NSH "LIRIA" (në likuidim), Prizren, të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Sabri Halili, dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjyqimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2703 të datës 26 shtator 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 26 tetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2703 të datës 26 shtator 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 08 prill 2014, paditësja përmes postës e dërgoj një ankesë në DHPGJS të paraqitur kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRZ041-0053 të datës 30 shtator 2013, me të cilin vendim ishte refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin e tri pagave të pa paguara në shumë prej 450,00 euro, me arsyetimin se bashkëshorti i paditëses A K ka vdekur me datë 13 qershor 2010, si pasojë ai nuk ka të drejtë në kompensim për tri paga të papaguara. Veç kësaj kërkesa është paraqitur dhe nënshkruar nga bashkëshortja e tij N K pa patur një akt përfaqësimi për të përfaqësuar të ndjerin. Tutje Autoriteti i Likuidimit konstaton se në bazë të nenit 359 të LMD-së, çdo detyrim i mundshëm i NSH-së ndaj A K ka përfunduar në momentin e vdekjes së tij. Paditësja në ankesë pohon se bashkëshorti i saj i ndjerë A K ka qenë punëtorë i NSH-së Liria në Prizren, deri me 30 nëntor 2010, kur AKP-ja atij ja ka dërguar Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, për shkak të privatizimit të NSH-së. Tutje paditësja në ankesë pohon se Vendimi i Autoritetit të Likuidimit është i pakuptimtë dhe i pa bazuar në ligj. Paditësja pohon se bashkëshorti i saj ka vdekur me 13.06.2012, pas privatizimit të ndërmarrjes. Paditësja pohon se ka të drejtë në tri paga të papaguara në shumë prej 450,00 euro për shkak të privatizimit të NSH-së.

Me datë 06 shkurt 2017, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja pohon se paditësi ka dështuar të tregoj cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur nga ana e Autoritetit të Likuidimit me vendimin e ankimuar. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa e paditësit për kompensimin e tri pagave të pa paguara në shumë prej 450,00 euro, ishte refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit pasi që bashkëshorti i paditëses A K ka vdekur me datë 13 qershor 2010, si pasojë ai nuk ka të drejtë në kompensim për tri paga të papaguara. Veç kësaj kërkesa është paraqitur dhe nënshkruar nga bashkëshortja e tij N K pa patur një akt përfaqësimi për të përfaqësuar të ndjerin. Tutje Autoriteti i Likuidimit konstaton se në bazë të nenit 359 të LMD-së, çdo detyrim i mundshëm i NSH-së ndaj A K ka përfunduar në

momentin e vdekjes së tij. Nga këto arsye AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 08 nëntor 2021, shkalla e I-rë e DHPGJS-së e lëshon edhe një Urdhër për paditësen dhe kërkon që të dërgon Aktvendimin e Trashëgimisë për të vërtetuar legjitimitetin aktivë të saj në procedurë.

Me datë 12 gusht 2022, paditësja e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS si përgjigje ndaj Urdhrit. Me këtë parashtresë paditësja ka dërguar Aktvendimin e Trashëgimisë LRP nr.882/2014 T.nr.Ref 348/2014 të datës 27.05.2014, si dhe Autorizimin për përfaqësim nga ana e Avokatit.

Me datë 26 shtator 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-2703 e aprovon ankesën e paditësit si të bazuar e ndryshon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, si dhe e detyron AKP-në ti paguaj paditëses tri pagat e papaguara, në shumën prej 450,00 euro që do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se bazuar në Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, bashkëshorti i ndjerë i paditëses A K ishte punëtor i NSH-së deri me 30 nëntor 2010. Edhe Libreza e punës vërteton se ai ishte punëtor i NSH-së deri me 30 nëntor 2010. Bashkëshorti i paditëses A K ka vdekur pas privatizimit të NSH-së me datë 13 qershor 2012, që do të thotë se ai ishte në punë deri në privatizimin e NSH-së. Tutje shkalla e I-rë konstaton se AKP-ja pa ndonjë bazë të vlefshme ligjore e ka refuzuar kërkesën për pagesën e tri pagave të papaguara, ndërsa arsyetimi i dhënë për refuzimin e kërkesës nuk është i bazuar dhe nuk mund të pranohet nga gjykata. Shkalla e I-rë konstaton se paditësja në bazë të Urdhrit ka sjellë Aktvendimin e Trashëgimisë T.nr.Ref.348/2014 të datës 27 maj 2014, me të cilin ajo është shpallë trashëgimtare e të ndjerit, dhe ka vërtetuar legjitimitetin e saj aktiv në procedurë.

Me datë 19 tetor 2022, AKP-ja përmes postës e dërgoj në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-2703 të datës 26 shtator 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes, duke i ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme njëra me tjetrën. Autoriteti i Likuidimit nuk e ka mohuar faktin se ndërprerja e marrëdhënies së punës së të ndjerit A K bashkëshort i paditëses është bërë për shkak të privatizimit të NSH-së. Tutje AKP-ja pohon se Autoriteti i Likuidimit ka sqaruar shumë qartë se janë dy afate të ndryshme të parashkrimit, njëri është afati për parashtrim të kërkesave që është afat procedural për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit, e tjetri është afati brenda të cilës mund të parashtrohet një kërkesë në merita që është afati për parashkrim e që i referohet nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Këto afate janë të ndara dhe të dallueshme dhe një kreditor i NSH-së duhet ti përmbush të dy afatet në mënyrë që kërkesa e tij të pranohet. Njoftimi i AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës nuk është dërguar që ti mbroj të drejtat e punëtorit, por ai është njoftim që i informon punëtorin se kërkesat do të shqyrtohen në procedurën e likuidimit. Tutje AKP-ja pohon se paditësja ka dështuar të sjell prova për të vërtetuar faktin se ai tri pagat e kërkuara, i ka kërkuar brenda 3 viteve në Gjykatën kompetente, andaj kërkesa për paga është parashkruar, në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Me datë 19 dhjetor 2022, paditësja e ka dorëzuar një parashtresë në DHPGJS, dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë, paditësja ka kundërshtuar pretendimet ankimore të AKP-së, dhe e mbështet në tërësi aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS, duke e konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Tutje ajo pohon se AKP-ja vetëm i ka përsëritur argumentet e dhëna më herët, dhe nuk ka paraqitur ndonjë provë apo argument të ri, që do ta ndryshonte gjendjen faktike të vërtetuar nga Shkalla e I-rë. Në këtë parashtresë, paditësja ka propozuar që të refuzohet ankesa e AKP-së si e pabazuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditurës refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjorë, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja me datë 09 korrik 2013 e ka dorëzuar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit në vend të bashkëshortit të saj të ndjerë A K , dhe ka kërkuar tri pagat e pa paguara nga NSH "Liria" në Prizren (në likuidim), për shkak të privatizimit të NSH-së në shumë prej 450,00 euro. Kjo kërkesë është refuzuar si e pa vlefshme nga ana e Autoritetit të Likuidimit me arsyetimin se bashkëshorti i paditëses A K ka vdekur me datë 13 qershor 2010, si pasojë ai nuk ka të drejtë në kompensim për tri paga të papaguara. Veç kësaj kërkesa është paraqitur dhe nënshkruar nga bashkëshortja e tij N K pa patur një akt përfaqësimi për të përfaqësuar të ndjerin. Tutje Autoriteti i Likuidimit konstaton se në bazë të nenit 359 të LMD-së, çdo detyrim i mundshëm i NSH-së ndaj A K ka përfunduar në momentin e vdekjes së tij.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin e ankimuar e ka aprovuar ankesën e paditëses si të bazuar dhe ka ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, duke konstatuar se bazuar në Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, bashkëshorti i ndjerë i paditëses A K ishte punëtor i NSH-së deri me 30 nëntor 2010, kur është privatizuar NSH-ja. Edhe Libreza e punës vërteton se ai ishte punëtor i NSH-së deri me 30 nëntor 2010.

Bashkëshorti i paditëses A K ka vdekur pas privatizimit të NSH-së me datë 13 qershor 2012, që do të thotë se ai ishte në punë deri në privatizimin e NSH-së. Andaj ka të drejtë në tri paga të papaguara për shkak të privatizimit të NSH-së.

Kolegji i Apelit nuk e mbështet arsyetimin e dhënë nga Autoriteti i Likuidimit për refuzimin e kërkesës, pasi që ky arsyetim nuk ka mbështetje ligjore. Kolegji i Apelit i mbështet si të sakta të gjitha konstatimet e dhëna nga ana e shkallës së I-rë, pasi që ato janë të drejta dhe të mbështetura në prova që paditësja i ka sjellë në gjykatë.

Kolegji i Apelit e ka pasur parasysh faktin se bashkëshorti i ndjerë i paditëses, A K ende sa ishte në jetë e kishte pranuar nga AKP-ja Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me datë 30 nëntor 2010. Bashkëshorti i ndjerë i paditëses ka vdekur pas privatizimit të NSH-së, do të thotë ai ka vdekur me datë 13 qershor 2012, ndërsa privatizimi i NSH-së ka ndodhë me 30 nëntor 2010. Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës, dhe kjo dëshmi vërteton po ashtu se bashkëshorti i ndjerë i paditëses A K ka punuar në NSH deri në ditën e privatizimit të saj.

Andaj bashkëshortja e të ndjerit ka të drejtë në tri paga të papaguara në shumë prej 450,00 euro për shkak të privatizimit të NSH-së. AKP-ja nuk e ka kontestuar në mbrojtje në ankesë në shkallën e I-rë, dhe as me ankesë në shkallën e dytë, lartësinë e kërkuar të kompensimit në emër të tri pagave të pa paguara. Shuma e aprovuar në emër të tri pagave të papaguara do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Nga këto arsye, Kolegji i Apelit e refuzon ankesën e AKP-së si të pa bazuar dhe e vërteton Aktgjykimin e ankimuar të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore me datë 10 nëntor 2022 në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 26 tetor 2023.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
